

WIDEX DREAM™

UDHËZIMET E PËRDORIMIT **THE WIDEX DREAM™ FAMILY**

Modeli D-FS
RIC/RITE
Spikeri në kanal/Spikeri në vesh



APARATI JUAJ I DEGJIMIT WIDEX

(Për tu plotësuar nga specialisti juaj i dëgjimit)

Seria e aparateve tuaja të dëgjimit:

Programet:

<input type="checkbox"/> Master
<input type="checkbox"/> Musikë
<input type="checkbox"/> TV
<input type="checkbox"/> Comfort
<input type="checkbox"/> Dëgjim prapa
<input type="checkbox"/> Telefon
<input type="checkbox"/> T
<input type="checkbox"/> M+T
<input type="checkbox"/> Zen
<input type="checkbox"/> Master + Zen
<input type="checkbox"/> Master + Dëgjim prapa
<input type="checkbox"/> Master + T
<input type="checkbox"/> Master + M+T
<input type="checkbox"/> Master + Telefon
<input type="checkbox"/> Zen+
<input type="checkbox"/> Telefon+

Data

Specialisti juaj i degjimit

TRYEZA E LËNDËS

APARATI I DEGJIMIT	6
Sinjalet akustike	10
Bateria	11
Vendosja e baterisë	11
Sirtari i baterisë pa kapëse për thoin	14
Treguesi i baterisë si dobët	15
Ndezja dhe fikja e aparatit të dëgjimit	16
Identifikimi, i djathtë/ i majtë	17
Pozicionimi i aparatit të dëgjimit	18
Heqja e aparatit të dëgjimit	20
Rregullimi i volumit	21
Problem në aparatit tjetër	24
Programet	25
Këmbimi mes programeve të dëgjimit	28
Zen+	29
Telefon+	29
Përdorimi i telefonit	30


PASTRIMI	31
Aparati i dëgjimit.....	32
AKSESORET	33
NE RAST KEQFUNKSIONIMI	34
MIREMBAJTJA E APARATIT TUAJ TE DEGJIMIT	37
PARALAJMERIME	38
KESHILLA	44
REGULATORY INFORMATION	45
SIMBOLET	51

APARATI I DEGJIMIT

Ilustrimi i mëposhtëm tregon aparatin e dëgjimit pa kufje. Kufjen mund ta zgjidhni sipas nevojave tuaja specifike. Lutemi referojuni manualit të përdorimit për kufjet që jepet veçan.

1. Çelësi ndez/fik
2. Sirtari i baterisë me kapëse për thoin
3. Butoni i programeve
4. LED & Identifikimi i djathtë/i majtë

Nqs keni nevojë të identifikoni numrin serial të produktit (zakonisht me gjashtë ose shtatë numra), kontaktoni me specialistin tuaj të dëgjimit.



SHENIM

Përveç këtij udhëzimi ju jepet vecan dhe një udhëzim përdorimi ku përshkruhen kufjet e ndryshme që përdoren për aparatit tuaj të dëgjimit:
“Kufje për aparate dëgjimi Widex BTE”



PARALAJMERIM

Kjo broshurë dhe manuali “Kufje për aparate dëgjimi Widex BTE”, përmbajnë informacion dhe udhëzime të rëndësishme. Lexojini me kujdes dy broshurat para se të filloni të përdorni aparatit e dëgjimit.

SHENIM

Aparati i dëgjimit dhe aksesoret mund të mos kenë pamje të njëjtë me çfarë tregojnë ilustrimet në broshurë. Ne ruajme të drejtën të bëjmë çdo ndryshim që e konsiderojmë të nevojshëm.

Përdorimi i synuar

Aparatet e dëgjimit janë paisje amplifikuese me përçim ajri të destinuara për përdorim në rrethana dëgjimi të zakonshme. Aparatet e dëgjimit mund të paisen dhe me programin Zen, që ofron një sfond dëgjimi relaksues (muzikë dhe zhurma), për persona në moshë madhore që dëshirojnë ti dëgjojnë këto në qetësi.

Udhëzimet për përdorim

Paisjet indikohen për rënie dëgjimi nga të lehta (16 dB HL në 25 dB HL) deri serioze (90+ dB HL) dhe në të gjitha konfigurimet.

Paisjet duhet të programohen nga specialistë të dëgjimit (audiologë, specialistë të dëgjimit, otolaringologë) të specializuar në (ri) aftësimin e dëgjimit.

Përshkrimi i paisjes

Aparati i dëgjimit përdoret me një kufje e cila përbëhet nga një tub dhe një veshore në të cilën është vendosur spikeri. Aparati juaj i dëgjimit përdor një teknologji wireless të certifikuar dhe WidexLink-u mundëson komunikimin midis dy aparateve të dëgjimit si dhe midis aparateve të dëgjimit dhe paisjeveDEX.

Aparati juaj i dëgjimit mund të programohet me një program të quajtur Zen. Ky program jep tone muzikore (dhe zhurma si fryrje ajri) në sfond. Këto tinguj janë të kombinuar me humbjen tuaj të dëgjimit.

Sinjalet akustike

Aparati i dëgjimit mund të programohet për të lëshuar sinjale që lajmërojnë përdorimin e disa funksioneve. Sinjali mund të jetë mesazh zanor ose ton. Sinjali mund të ç'aktivizohet.

Funksionet	Cilësimet e parazgjedhura	Cilësime të tjera
Rregullimii volumit	Ton	Fikur
Konfirmim i përdorimit të butonit të programeve	Tingull klikues	Fikur
Ndryshimi i programit	Mesazh	Ton/fikur
Nisja e aparatit të dëgjimit	Mesazh	Ton/fikur
Paralajmërim për bateri të dobët	Mesazh	4 tone/fikur
Paralajmërim për problem në aparatit tjetër	Fikur	Mesazh
Përkujtesë shërbimi	Fikur	Mesazh

Shënim: "Paralajmërim për problem në aparatit tjetër" mund të aplikohet vetëm tek DREAM440.

Bateria

Ne rekomandojmë bateri me zink-ajër. Përdorni një bateri të modelit 312 për aparatën e dëgjimit.

Kur keni nevojë për të ndërruar baterinë, konsultojtu me specialistin tuaj të dëgjimit. Ka rëndësi të shikohet data e skadencës së baterisë dhe rekomandimet në paketën e baterisë në lidhje me eliminimin e baterive të shkarkuara.

Vendosja e baterisë




Para se të fusni një bateri të re në aparatën e dëgjimit, mos harroni të hiqni gjuhën ngjitëse. Pasi ta keni hequr atë, bateria do fillojë të funksionojë pas pak sekondash




KUJDES

Mos e përdorni baterinë nqs ka ndonjë mbetje ngjitëse nga gjuha ose ndonjë lëndë tjetër e padëshiruar, sepse kjo mund të shkaktojë keqfunksionimin e aparatit të dëgjimit.




Përdorni kapësen për thoin që të hapni sirtarin e baterisë. Mos e shtyni sirtarin përtej pozicionit të hapur.

Vendosni baterinë në sirtar siç tregohet, në mënyrë që shenja(+) në bateri të jetë e kthyer nga ju. Mund të përdorni magnetin e baterisë që ju është dhënë për ta çuar baterinë në vendin e vet.



Nqs sirtari i baterisë nuk mbyllet lehtë, bateria nuk është vendosur siç duhet.

Kur ndërroni baterinë, bëni mirë ta mbani aparatin e dëgjimit mbi tryezë.



Sirtari i baterisë pa kapëse për thoin

Aparati i dëgjimit mund të vijë me një sirtar baterie pa kapëse për thoin, çka do të thotë se do ju duhet një vegël për ta hapur sirtarin. Ky lloj sirtari mund të jetë i dobishëm, nëqë aparati i dëgjimit përdoret nga një fëmijë. Në raste të tilla aparati i dëgjimit do ju vijë me një vegël të posaçme për të hapur sirtarin.



Sirtari i baterisë hapet siç tregohet në figurë.

Treguesi i baterisë si dobët

Një sinjal akustik do të dëgjohet kur bateria është pothuajse e harxhuar, me kusht që të mos e keni ç'aktivizuar këtë funksion (shih faqen 10). Rekomandojmë që të mbani gjithnjë një bateri rezerve me vehte.



PARALAJMERIM

Kurrë mos e lini baterinë e harxhuar në aparatin e dëgjimit. Bateritë e harxhuara mund të rrjedhin dhe të dëmtojnë aparatin e dëgjimit.




PARALAJMERIM

Aparati i dëgjimit e ndërpret funksionimin kur bateria ka mbaruar. Këtu duhet ta keni parasysh, sidomos kur gjendeni në trafik ose në situata kur është e nevojshme të dëgjoni sinjale paralajmëruese.

Ndezja dhe fikja e aparatit të dëgjimit

Sirtari i baterisë së aparatit të dëgjimit funksionon dhe si çelës ndez/fik.




Mbylleni sirtarin e baterisë për ta ndezur aparatin e dëgjimit. Një sinjal akustik do të lajmërojë se aparati i dëgjimit është ndezur, me kusht që të mos e keni ç'aktivizuar këtë funksion.

Për ta fikur aparatin e dëgjimit, hapeni sirtarin e baterisë derisa të dëgjohet një klik i lehtë.

SHENIM: Tjetër rrugë për të verifikuar që aparati i dëgjimit është ndezur, është që ta mbash atë në dorë. Nqs është i ndezur ai do të fërshëllejë.

Mos harroni që të fikni aparatin e dëgjimit kur nuk po e përdorni. Hiqeni baterinë nqs nuk do ta përdorni aparatin e dëgjimit për disa ditë rresht.



Identifikimi, i djathtë/ i majtë


Nqs mbani aparate dëgjimi në të dy veshët. Mund t'ju vijjë me shenja me ngjyra të ndryshme (shenja kuqe=djathtas dhe shenja blu= majtas).

Shigjeta tregon pozicionin e shenjës identifikuese.

Pozicionimi i aparatit të dëgjimit

Futni veshoren në kanalën e veshit, duke mbajtur me dorë pjesën e poshtme të tubit. Nëse kjo ndihmon, tërhiqeni me dorën tjetër llapën e veshit nga jashtë dhe lart.

Vendoseni aparatën e dëgjimit prapa veshit, në mënyrë që aparatë dhe tubi të mbështeten rehatshëm në vesh, afër kokës tuaj.




Ilustrimet tregojnë një pipëz të hapur. Për informacion të mëtejshëm për llojet e pipëzave dhe veshoreve, ankorimet dhe procedurat përkatëse, shihni manualin e përdorimit të kufjeve që është më vehte.

Nqs kufja nuk rrin siç duhet, shkakton skuqje ose irrim të kanalit të veshit, kontakto me specialistin tuaj të dëgjimit.

Heqja e aparatit të dëgjimit

Hiqeni aparatin e dëgjimit nga vendi i tij pas veshit.

Hiqeni me kujdes veshoren nga kanali i veshit, duke mbajtur me dorë pjesën e poshtme të tubit. Nqs veshorja ju ka ardhur me një spango nxjerrëse plastike, kapeni atë dhe tërhiqeni me kujdes pipëzen nga kanali i veshit.



Rregullimi i volumit

Volumi i aparatit të dëgjimit rregullohet automatikisht sipas mjedisit akustik ku gjendeni.

Nqs keni telekomandë mund ta rregulloni volumin manualisht ose ta heshtoni aparatit e dëgjimit. Ç'do rregullim që mund t'ja keni bërë volumit do të anulohet kur ta fikni aparatit e dëgjimit ose kur të ndërroni programin.

Në varësi të karakteristikave dhe vendosjes së aparatit të dëgjimit, çdo ndryshim që do të bëni do të ndikojë në të dy aparatet e dëgjimit.

Për të ndryshuar përfitimet ku kërkohet rritja ose ulja e volumit, konsultojuni me specialistin tuaj të dëgjimit.

Nqs keni telekomandë, referojuni edhe udhëzimeve të përdorimit për telekomandën.



PARALAJMERIM

Me një veshore të prodhuar me porosi, ky aparat dëgjimi është i aftë të prodhojë presion zëri deri në 132 dB SPL.

Kjo paraqet rrezik për dëmtimin e dëgjimit tuaj të mbetur.



KUJDES

Nqs volumi i aparatit të dëgjimit është në përgjithësi i lartë ose tepër i ulët, tingujt riprodhohen të deformuar, ose nqs dëshironi ndonjë informacion tjetër, këshillohuni me specialistin tuaj të dëgjimit.

Për ta heshtur aparatin e dëgjimit me telekomandë.

Mbani të shtypur tastin e uljes së volumit në telekomandë pasi të ketë filluar të dëgjohet një bip i gjatë dhe derisa ky të ndalojë. Tingullin mund ta ktheni sërish duke shtypur pak cilindo prej tasteve të volumit.

SHENIM: Aparati juaj i dëgjimit mund të paiset me një rritje graduale të amplifikimit të dëgjimit, derisa ju të klimatizoheni me tingujt e rinj. Ju do të njoftoheni për rritjen e nivelit të amplifikimit pas një periudhë kohe.

Problem në aparatën tjetër

(Shënim: Aplikohet vetëm kur ky opsion është i disponueshëm dhe aktivizohet vetëm nga specialisti juaj i dëgjimit).

Nqs njëri nga aparatet e dëgjimit ka problem ose i mbaron bateria, një mesazh zanor dhe një ton do dëgjohen dy herë në aparatën tjetër të dëgjimit, dhe një dritë (LED) do pulsojë në të dy aparatet e dëgjimit.

Kur problem është zgjidhur ose është vënë bateria e re, drita do ndalojë së pulsuar.

Programet

Aparati juaj i dëgjimit mund të paiset me disa nga këto programe, gjithashtu dhe programin special Zen të quajtur Zen+. Në disa aparate dëgjimi DREAM, programi Telefon+ vihet në dispozicion në vend të programit Zen+.

Master	Standard
Musikë	Për të dëgjuar muzikë
TV	Për të dëgjuar TV
Comfort	Zbut zhurmat e mjedisit
Dëgjim prapa	Fokuson dëgjimin e tingujve prapa
Telefon	Për të folur në telefon
T	Në këtë program dëgjoni nëpërmjet telebabinës (T) dhe jo mikrofona të aparatit të dëgjimit (M). Telebobina përdoret atje ku është instaluar një sistem cikël. Nqs ju e aktivizoni programin e telebabinës, do të dëgjoni një burim tingullor specifik, ndërsa tingujt e mjedisit rrethues do të përjashtohen.

M+T	Ky program ju lejon të dëgjoni nëpërmjet mikrofonave të aparatit të dëgjimit (M) dhe telebabinës (T)
Zen	Prodhon lloje të ndryshme zhurmash dhe tonesh
Program i perzier	Program Master në njërin vesh dhe Zen,Telefon ose Dëgjim prapa në veshin tjetër
Zen+	Program special Zen me më shumë se tre lloje Zen
Telefon+*	Përdoret vetëm për telefon. Transmeton zërin nga një aparat dëgjimi në tjetrin. Duhet të dini se mikrofoni në të cilën transmetohet zëri është i fikur.

** vetëm në disa aparate dëgjimi DREAM*


Në varësi të shkallës së humbjes së dëgjimit, audiologu juaj mund të aktivizojë funksionalitetin e Zgjatësit të dëgjueshmërisë. Pyesni audiologun tuaj nëse ju mund të përfitoni nga kjo.

Nqs me kalimin e kohës keni nevojë të ndryshoni programet , kombinimi i programeve mund të ndryshojë.



KUJDES

Kur zgjidhni Telefon+ si program dëgjimi, ju lutem mos harroni se ka situata në të cilat është shumë e rëndësishme të dëgjohen tingujt përreth



Këmbimi mes programeve të dëgjimit

Për të ndryshuar programin, shtypni shkurt butonin e programeve. Sa herë që ndërroni programin do të lajmëroheni me një sinjal akustik, me kusht që të mos e keni ç'aktivizuar këtë funksion.

- Programi 1:** Mesazh ose një bip i shkurtër
- Programi 2:** Mesazh ose dy bipe të shkurtër
- Programi 3:** Mesazh ose tre bipe të shkurtër
- Programi 4:** Mesazh ose një bip i gjatë dhe një i shkurtër
- Programi 5:** Mesazh ose një bip i gjatë dhe dy të shkurtër
- Zen+ or Telefon+:** Mesazh ose ton

Në varësi të karakteristikave të dëgjimit dhe mjedisit, çdo ndryshim që ju do bëni, do veprojë në të dy aparatet e dëgjimit.

Zen+

Ky program aktivizohet duke mbajtur të shtypur gjatë (më shumë se një sekond) butonin e programit të aparatit të dëgjimit ose të RC-DEX. Me një shtypje të shkurtër ju mund të kaloni në llojet e ndryshme të Zen-it.


Ju mund të dilni nga Zen+ duke mbajtur të shtypur butonin e programeve për më shumë se një sekond.

Telefon+

Nqs aparati juaj i dëgjimit është programuar me Telefon+ në vend të Zen+, ky program aktivizohet duke e mbajtur të shtypur gjatë (më shumë se një sekond) butonin e programit të aparatit të dëgjimit.

Ju mund të dilni nga Telefon+ duke mbajtur të shtypur butonin e programeve për më shumë se një sekond.

Nqs ju dëshironi të ç'aktivizoni butonin e programeve, konsultojtu me specialistin tuaj të dëgjimit.




Përdorimi i telefonit

Kur përdorni një telefon, ju rekomandojmë ta mbani telefonin përballë kokës suaj, me një kënd mbi vesh, dhe jo drejtëpërdrejtë në vesh. Nqs tingulli nuk është optimal, provoni ta zhvendosni telefonin në një pozicion tjetër.

PASTRIMI


Me aparatën e dëgjimit dhe kufjen*, mund të përdoren aksesoret e mëposhtëm. Për të pastruar kufjen, shihni manualin e përdorimit “Kufjet për aparate dëgjimi Widex BTE”.

1. Leckë
2. Vegël për heqjen e dyllit
3. furçë



Kontakto me specialistin tuaj të dëgjimit, nës keni nevojë për aksesore pastrimi të tjerë.

** Asortimenti varet nga lloji i kufjes.*



Aparati i dëgjimit


Pastrojeni aparatin e dëgjimit me leckën e butë pas përdorimit.

Nqs vrima e mikrofonit është akoma e bllokuar, kontakto me specialistin tuaj të dëgjimit.



PARALAJMERIM

Mos përdorni kurrë ujë ose solucione pastrimi me aparatin e dëgjimit, pasi kjo mund ta bëjë te keqfunksionojë.



Kur aparati i dëgjimit nuk është në përdorim, sirtari i baterisë duhet mbajtur i hapur, për ta ajrosur aparatin dhe për ta lënë të thahet.

AKSESORET

Një larmi paisjesh ndihmëse dëgjimi janë në dispozicion për aparatit tuaj të dëgjimit.

RC-DEX	telekomandë
TV-DEX	Për të dëgjuar TV dhe audio
M-DEX	Përdoret për celular dhe telekomandë
PHONE-DEX	Përdoret me kabëll*
T-DEX	Për të lidhur aparatit e dëgjimit me celularin gjatë përdorimit të telebabinës.
FM+DEX	FM+DEX është një pajisje e cilësisë së lartë e prodhuar posaçërisht për aparatet e dëgjimit Widex

** Në dispozicion vetëm për disa shtete*

NE RAST KEQFUNKSIONIMI

Problemi	Shkak i mundshëm	Zgjidhja
Aparati i dëgjimit është krejt i heshtur	Aparati i dëgjimit nuk është ndezur	Sigurohu që sirtari i baterisë është i mbyllur
	Bateria nuk punon	Vendosni një bateri të re në sirtarin e baterisë
Volumi i aparatit të dëgjimit nuk është aq i fortë sa duhet	Veshi juaj është bllokuar nga dylli	Kontakto me mjekun tuaj ORL
	Dëgjimi juaj mund të ketë ndryshuar	Kontakto me specialistin tuaj të dëgjimit
Aparati i dëgjimit fishkëllen papushim	Veshi juaj është bllokuar nga dylli	Kontakto me mjekun tuaj ORL

Problemi	Shkak i mundshëm	Zgjidhja
Dy aparatet e dëgjimit nuk janë duke punuar në sinkron	Eshtë humbur lidhja mes dy aparateve të dëgjimit	Fikeni aparatin e dëgjimit dhe ndizeni përsëri
Aparati i dëgjimit nuk i përgjigjet ndryshimeve të volumit ose programeve të bëra nga paisja DEX	<ul style="list-style-type: none"> a. Paisja DEX është përdorur përtej rrezes së transmetimit b. Interferencë e lartë elektromagnetike në afërsi c. DEX dhe aparati i dëgjimit nuk përputhen 	<ul style="list-style-type: none"> a. Afroje DEX me afër aparatit të dëgjimit b. Largoju nga burimi i interferencës c. Lidhuni me specialistin tuaj të dëgjimit për të bërë lidhjen mes paisjes DEX dhe aparatit të dëgjimit

Problemi	Shkak i mundshëm	Zgjidhja
Ju dëgjoni zërin me ndërprerje (ndez/fik) ose nuk dëgjoni asgjë (heshtje) në aparatin e dëgjimit	<p>a. Njëra bateri e aparatit të dëgjimit ka mbaruar</p> <p>b. Interferencë e lartë elektromagnetike në afërsi</p>	<p>a. Vendos bateri në një ose dy aparatet e dëgjimit</p> <p>b. Largoju nga burimi i interferencës</p>

SHENIM: Ky informacion mbulon vetëm aparatin e dëgjimit. Shiko udhëzimin “Kufje për aparate dëgjimi Widex BTE” për informacion specifik rreth kufjeve.

Nqs problemi vazhdon përsëri, kontakto me specialistin tuaj të aparateve të dëgjimit.

MIREMBAJTJA E APARATIT TUAJ TE DEGJIMIT

Aparati i dëgjimit është një send me vlerë dhe duhet trajtuar me kujdes. Ja çfarë mund të bëni, për t'ia zgjatur jetën aparatit tuaj të dëgjimit:



KUJDES

- Fikeni aparatin e dëgjimit, kur nuk është në përdorim. Hiqeni baterinë, nëqë nuk do ta përdorni aparatin e dëgjimit për disa ditë rresht.
- Kur aparati i dëgjimit nuk është në përdorim, mbajeni në kutinë e vet, në një vend të thatë, larg fëmijëve dhe kafshëve shtëpiake.
- Mos e ekspozoni aparatin e dëgjimit ndaj temperaturave të skajshme ose lagështisë së madhe. Sigurohuni që ta thani mirë aparatin e dëgjimit pasi të keni djersitur shumë, siç mund të ndodhë gjatë një veprimtarie fizike intensive, psh. kur merreni me sport.
- Mos e lini aparatin e dëgjimit të bjerë në tokë- mbajeni mbi një sipërfaqe të butë, kur po e pastroni ose kur ndërroni baterinë.
- Mos e mbani aparatin e dëgjimit në vesh, kur jeni duke bërë dush ose duke notuar, ose kur përdorni spraj për flokët, xhel, apo kremra plazhi.

PARALAJMERIME



PARALAJMERIM

Aparatet e dëgjimit dhe bateritë mund të jenë të rrezikshme nëse qëlltiten ose përdoren në mënyrë të papërshtatshme. Gëlltitja ose përdorimi i papërshtatshëm mund të shkaktojnë lëndime të rënda ose edhe vdekjen. Në rast qëllitje, lajmëroni menjëherë mjekun.

- Mbajini aparatet e dëgjimit dhe pjesët e tyre, aksesorët dhe bateritë larg fëmijëve dhe kujdo tjetër që mund ti qëlltitë këto sende ose të lëndojë veten me ndonjë mënyrë tjetër. Mos i ndërroni bateritë para tyre dhe mos i lejoni ti shohin se ku i mbani bateritë rezervë. Tregoni kujdes kur i eliminoni bateritë e përdorura.
- Bateritë janë shumë të vogla dhe mund të ngatërrohen lehtë me tabletat ose sende të ngjashme. Kurrë mos e futni një bateri ose aparatin e dëgjimit në gojë për asnjë arsye, sepse mund ta qëlltisni padashur.



PARALAJMERIM

- Pas përdorimit, pastroje dhe kontrolloje aparatit e dëgjimit për të parë që është në rregull. Nqs aparati i dëgjimit ndahet në pjesë kur është në kanalit e veshit, kontakto menjëherë me specialistin tuaj të dëgjimit. Mos u perpiq kurrë që ta heqësh pjesën e mbetur në kanalit e veshit vetë.
- Ka rrezik shpërthimi nqs bateria zëvendësohet me një tjetër të një lloji të papërshtatshëm ose ringarkohet. Eliminoni bateritë e përdorura sipas udhëzimeve.
- Mos i lejoni asnjëherë të tjerët që të përdorin aparatit tuaj të dëgjimit, meqë kjo mund t'u shkaktojë atyre dëmtim të përhershëm në dëgjim.
- Kur përzgjidhni një program dëgjimi, mbani parasysh se ka situata në të cilat është tejet e rëndësishme që të mund të dëgjoni tingujt rrethues (p.sh. në trafik, ose sinjale paralajmëruese).



PARALAJMERIM

- Aparati i dëgjimit është i prodhuar me materiale moderne, jo-alergjike. Megjithatë në raste të rralla, mund të ndodhë irritim i lëkures. Nqs vëreni irritim të lëkurës në vesh, në kanalim e veshit ose në zonat përreth, lidhuni me specialistin tuaj të dëgjimit.
- Duhet të keni parasysh që gjatë përdorimit të aparatit të dëgjimit, ju duhet të bëni një ventilim të rregullt të veshit. Nqs nuk sigurohet kjo mund të keni një rrezik të shtuar për infeksion ose sëmundje të kanalit të veshit. Prandaj ne rekomandojmë që ta hiqni aparatim e dëgjimit dhe kufjen nga veshi natën, për të lejuar ventilimin e kanalit të veshit. Nqs është e mundur, ju duhet ta hiqni aparatim e dëgjimit dhe kufjen edhe gjatë ditës, në periudha kur nuk keni nevojë për të. Sigurohuni që ta pastroni dhe ta mirëmbani aparatim e dëgjimit dhe kufjen siç kërkohet. Nëse një infeksion ndodh, kërkoni ndihmë mjekësore dhe lidhuni me specialistin tuaj të dëgjimit për tu këshilluar rreth dezinfektimit të pjesëve të ndryshme të aparatit të dëgjimit. Në asnjë rrethanë mos përdorni alkool, klor ose lëndë tjera të ngjashme.



PARALAJMERIM

- Përdorimi i rregullt i kapsulave kundër lagështires, rekomandohet për të shmangur keqfunksionimin e aparatit të dëgjimit.
- Mos e përdorni aparatin e dëgjimit në miniera ose zona të tjera ku mund të ketë gazra shpërthyes.



PARALAJMERIM

- **Mos e mbani aparatin e dëgjimit kur trajtoheni me rreze, bëni radiografi, MRI, CT ose trajtime dhe skanime mjekësore.** Rrezet nga këto procedura, si dhe nga lloje të tjera rrezatimi, të tilla si ato që lëshon një sobë me mikrovalë, mund ta dëmtojnë aparatin tuaj të dëgjimit. Rrezatimi nga paisjet e survejimit të dhomave, sistemet e alarmit kundër vjedhjeve, dhe i telefonave celular është më i dobët dhe nuk do ta dëmtojë aparatin e dëgjimit, por mund të krijojë interferenca të dëgjueshme.



PARALAJMERIM

Interferenca me implantet aktive.

- Për kujdesin tuaj, ne ju rekomandojmë që të ndiqni udhëzimet që japin prodhuesit e defibrilatorëve dhe stimuluesve kardiakë në lidhje me përdorimin e telefonave celular:
- Nqs keni një paisje implanti aktiv, mbani aparatet e dëgjimit, aksesoret e saj dhe telekomandën wireless të paktën 15 cm larg nga implanti.
- Nqs nga përvoja juaj keni interferenca, ju lutem mos e përdorni aparatën e dëgjimit dhe kontaktoni me prodhuesit e implantit. Interferenca mund të shkaktohet nga linjat e energjisë, shkarkimet elektrostatike, dedektorët e metalit në aeroporte etj.
- Nqs keni një implant aktiv të trurit, ju lutemi kontaktoni me prodhuesit e implantit për vlerësimin e rrezikut.

Nqs keni një implant aktiv, ju duhet të mbani paisjet magnetike* të pakten 15 cm larg implantit. (*= mund të quhen të tilla pjesët magnetike të telefonit, instrumentat e dëgjimit, magneti si një vegël etj.)



KUJDES

- Aparati juaj i dëgjimit është testuar për interferenca sipas standarteve ndërkombëtare. Megjithatë interferenca të paparashikuara mund të ndodhin në aparatin e dëgjimit për shkak të rrezatimit elektromagnetik nga pajse të tilla si sistemet e alarmit, pajset e surveimit të dhomave dhe telefonave celular.
- Edhe pse aparati i dëgjimit është ndërtuar në përputhje me standartet më të rrepta ndërkombëtare elektromagnetike, nuk përjashtohet mundësia e interferencës me pajset e tjera siç janë ato mjekësore.
- Asnjëherë mos u perpiq për ta hapur vetë ose për ta riparuar aparatin e dëgjimit.

KESHILLA

SHENIM

- Aparati i dëgjimit nuk do të rikthejë dëgjimin normal dhe nuk do të papandalojë as do të përmirësojë një humbje dëgjimi që vjen nga një sëmundje organike. Megjithatë aparati i dëgjimit mund t'ju ndihmojë ta përdorni sa më mirë atë aftësi dëgjimi që ju ka mbetur. Duhet të keni parasysh edhe se mund t'ju duhet kohë për tu mësuar me një aparat të ri dëgjimi dhe tingujt e rinj.
- Në shumë raste, po të mos e përdorni shpesh aparatën e dëgjimit, nuk do të mund të përfitoni maksimumin e tij.
- Përdorimi i një aparati dëgjimi është vetëm pjesë e aftësisë të dëgjimit dhe mund të duhet të shoqërohet nga stërvitja dëgjimore dhe për leximin e buzëve.
- Përdorimi i aparateve të dëgjimit rrit rrezikun e grumbullimit të dyllit në veshë. Lidhuni me mjekun tuaj ORL, nqs dyshoni që ju është krijuar në vesh një tapë dylli. Dylli jo vetëm mund t'ju dëmtojë dëgjimin, por edhe të ndikojë ndjeshëm në rendimintin e aparatit të dëgjimit. Bëni mirë që t'i pastroni veshët nga dylli dy herë në vit.

REGULATORY INFORMATION

FCC ID: TTY-DFS

IC: 5676B-DFS

Federal Communications Commission Statement

This device complies with part 15 of the FCC Rules. Operation is subject to the following two conditions:

- (1) This device may not cause harmful interference, and
- (2) this device must accept any interference received, including interference that may cause undesired operation.

NOTE:

This equipment has been tested and found to comply with the limits for a Class B digital device, pursuant to part 15 of the FCC Rules. These limits are designed to provide reasonable protection against harmful interference in a residential installation. This equipment generates, uses and can radiate radio frequency energy and, if not installed and used in accordance with the instructions, may cause harmful interference to radio communications. However, there is no guarantee that interference will not occur in a particular installation. If this equipment does cause

harmful interference to radio or television reception, which can be determined by turning the equipment off and on, the user is encouraged to try to correct the interference by one or more of the following measures:

- Reorient or relocate the receiving antenna.
- Increase the separation between the equipment and receiver.
- Connect the equipment into an outlet on a circuit different from that to which the receiver is connected.
- Consult the dealer or an experienced radio/TV technician for help.

NOTE:

This equipment complies with FCC radiation exposure limits set forth for an uncontrolled environment. This transmitter must not be co-located or operating in conjunction with any other antenna or transmitter.

Changes or modifications to the equipment not expressly approved by Widex could void the user's authority to operate the equipment.

Industry Canada Statement/Déclaration d'industrie Canada

Under Industry Canada regulations, this radio transmitter may only operate using an antenna of a type and maximum (or lesser) gain approved for the transmitter by Industry Canada.

To reduce potential radio interference to other users, the antenna type and its gain should be so chosen that the equivalent isotropically radiated power (e.i.r.p.) is not more than that necessary for successful communication.

This device complies with Industry Canada licence-exempt RSS standard(s). Operation is subject to the following two conditions:

- (1) this device may not cause interference, and
- (2) this device must accept any interference, including interference that may cause undesired operation of the device.

Conformément à la réglementation d'Industrie Canada, le présent émetteur radio peut fonctionner avec une antenne d'un type et d'un gain maximal (ou inférieur) approuvé pour l'émetteur par Industrie Canada.

Dans le but de réduire les risques de brouillage radioélectrique à l'intention des autres utilisateurs, il faut choisir le type d'antenne et son gain de sorte que la puissance isotrope rayonnée équivalente (p.i.r.e.) ne dépasse pas l'intensité nécessaire à l'établissement d'une communication satisfaisante.

Le présent appareil est conforme aux CNR d'Industrie Canada applicables aux appareils radio exempts de licence. L'exploitation est autorisée aux deux conditions suivantes :


- (1) l'appareil ne doit pas produire de brouillage, et
- (2) l'utilisateur de l'appareil doit accepter tout brouillage radioélectrique subi, même si le brouillage est susceptible d'en compromettre le fonctionnement.

Direktiva 1999/5/EC

Me anë të kësaj, Widex A/S deklaron qe D-FS është në përputhje me kërkesat themelore dhe dispozitat përkatëse të Direktivës 1999/5/EC.

Një kopje e Deklaratës së Konformitetit sipas 1999/5/EC mund ta gjeni në:

<http://www.widex.com/doc>









Paisjet elektrike dhe elektronike (EEE) përmbajne materiale, komponente dhe substanca që mund të jenë të rrezikshme për shëndetin e njeriut dhe mjedisin kur mbeturinat e paisjeve elektrike dhe elektronike (WEEE) nuk trajtohen si duhet.






Mos i hidhni aparatet e dëgjimit, paisjet ndihmëse të tyre dhe bateritë në mbeturinat e zakonshme shtëpiake.





Aparatet e dëgjimit, bateritë dhe aksesorët ndihmës duhet të hidhen në vende të caktuara për mbeturina elektrike dhe elektronike ose ti jepen specialistit të aparateve të dëgjimit për një asgjësim të sigurt. Asgjësimi i duhur ndihmon për mbrojtjen e shëndetit të njeriut dhe mjedisit.





SIMBOLET


Simbolet që përdoren zakonisht nga Widex A/S në etiketat e pajisjeve mjekësore (etiketat/Udhëzimet e Përdorimit/etj.)

Simboli	Titulli/Përshkrimi
	Fabrikanti Produkti është prodhuar nga fabrikanti, emri dhe adresa e të cilit gjenden përbri simbolit. Nëse është rasti, mund të jepet edhe data e fabrikimit.
	Data e fabrikimit Data kur u fabrikua produkti.
	Data e skadimit Data pas së cilës produkti nuk duhet përdorur.
	Kodi i ngarkesës Kodi i ngarkesës së produktit (identifikimi i ngarkesës ose i partisë).

Simboli	Titulli/Përshkrimi
	<p>Numri i katalogut Numri i katalogut (i artikullit) i produktit.</p>
	<p>Numri serial Numri i serial i produktit.*</p>
	<p>Mos e lini produktin në diell Produkti duhet mbrojtur nga drita dhe/ose Produkti duhet mbajtur larg burimeve të nxehtësisë</p>
	<p>Mbajeni të thatë Produkti duhet mbrojtur nga lagështira dhe/ose Produkti duhet mbrojtur nga shiu</p>
	<p>Caku i poshtëm i temperaturës Temperatura më e ulët ndaj së cilës produkti mund të ekspozohet pa dëme.</p>

Simboli	Titulli/Përshkrimi
	<p>Caku i sipërm i temperaturës Temperatura më e lartë ndaj së cilës produkti mund të ekspozohet pa dëme.</p>
	<p>Caqet e temperaturës Temperatura më e lartë dhe më e ulët, ndaj të cilave produkti mund të ekspozohet pa dëme.</p>
	<p>Këshillohuni me udhëzimet e përdorimit Udhëzimet e përdorimit përmbajnë informacion të rëndësishëm për t'u ndjekur (paralajmërimet dhe njoftime kujdesi), dhe duhen lexuar para se të përdoret produkti.</p>
	<p>Kujdes/Paralajmërim Teksti i shënuar me një simbol të kujdesit/paralajmërimit duhet lexuar para se të përdoret produkti.</p>

Simboli	Titulli/Përshkrimi
	<p>Shenja WEEE “Mos e hidhni në plehrat komunale”</p> <p>Kur vjen koha për ta hedhur produktin, duhet ta dorëzoni te një pikë grumbullimi e destinuar për riciklim dhe rikuperim.</p>
	<p>Shenja CE</p> <p>Produkti pajtohet me kërkesat e cilësuar në direktivat europiane të shënjitimit BE.</p>
	<p>Sinjalizim</p> <p>Direktiva R&TTE 1999/5/EC e identifikon produktin si pajisje të Klasës 2 me disa kufizime përdorimi në disa shtete anëtare të BE.</p>
	<p>Shenja C-Tick</p> <p>Produkti pajtohet me kërkesat rregullatore të spektrit EMC dhe radiovalor për produkte për tregun në Australi ose në Zelandën e Re.</p>

Simboli	Titulli/Përshkrimi
	Interferenca Në afërsi të produktit mund të ndodhë interferencë elektromagnetike.

Numri gjashtë- ose shtatë-shifror në produkt është numri serial. Numrat serialë jo gjithnjë paraprihen nga **SN**



WIDEX A/S

Nymoellevej 6, DK-3540 Lyngby, Denmark
www.widex.com

CE 0459

Manuali nr.:
9 514 0218 045 #03
Botimi:
2016-02



9 514 021 804 505